



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Arsimit
Periudha raportuese	Tetor, 2021
Emri dhe mbiemri i raportuesit	DKA-Prishtinë

Përmbledhje përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Drejtoria e Arsimit, gjatë muajit tetor të vitit 2021, ka arritur me sukses dhe rezultate të kënaqshme t'i realizojë të gjitha punët dhe detyrat e parapara sipas planit të veprimit me punë dhe detyra tjera.

Aktivitetet e planifikuara - Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara në bazë të planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj.

- ***Mbikëqyrje të vazhdueshme të procesit edukativo-arsimor;***

Mbështetja dhe mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar në komunën tonë, është duke u realizuar në vazhdimësi nga zyrtarët e arsimit, të cilët sipas planit dinamik janë duke operuar në terren dhe duke i përcjellë nga afër ecurinë e zhvillimeve në arsim dhe njëkohësisht duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale në këtë kohë pandemie që po kalon vendi.

- *Vizita të përgjithshme-këshilluese në institucionet arsimore;*

-Sipas dinamikës së planifikuar përfaqësuesit e Drejtorisë së Arsimit, gjatë muajit tetor kanë realizuar planin operues, si: vizita informuese, kontrolluese dhe të përgjithshme në institucionet e nivelit të Arsimit Parauniversitar.

Sot, në emër të Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Prishtinës, bashkë me ambasadorën e Francës, zonjën Marie-Christine Butel, në bashkëpunim me OJQ “Play International” dhe EUNIC, u shënuar Dita evropiane e gjuhëve.

Duke pasur parasysh se diversiteti i gjuhëve të huaja rrit shumë gjuhësinë dhe të kuptuarit ndërkulturor me shumë kombe, në vazhdimësi inkurajojmë nxënësit për mësim të gjuhëve të huaja, brenda dhe jashtë shkollave, për studime, nevoja profesionale, për udhëtime për shkëmbime të përvojave, mendimeve dhe ideve.



Është kënaqësi e madhe që nxënësit tanë i duan gjuhët e huaja dhe i mësojnë me shumë etje e kënaqësi. Shumica nga ta ende pa e përfunduar arsimin e obligueshëm 9-vjeçar, komunikojnë rrjedhshëm në dy e më tepër gjuhë të huaja dhe këtë e bëjnë me kënaqësi, pa i obliguar, si formë e mësimi zgjedhor.

Mësimi i gjuhëve të huaja është një mjet i vlefshëm, për të marrë më shumë nga jeta, kultura dhe përvoja e kombeve që do ta ndihmojë çdo nxënës në avancim për jetë.

Në komunën e Prishtinës mësohen katër gjuhë, duke e përfshirë edhe gjuhën franceze, ku tashmë janë të përfshirë mijëra nxënës në shtatë shkolla.

DKA është e përkushtuar që gjuha frënge dhe gjuhët tjera të reja të zgjerohen edhe në shkolla tjera.



- **Zbatimi i planit për tejkalimin e masave, sfidave, vështirësive dhe pengesave;**

Mbështetja dhe mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar në komunën tonë, është duke u realizuar në vazhdimësi nga zyrtarët e arsimit, të cilët sipas planit dinamik janë duke operuar në terren dhe duke e përcjellë nga afër ecurinë e zhvillimeve në arsim, dhe njëkohësisht duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale në këtë kohë pandemie që po kalon vendi.

Kështu që, sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë gjatë muajit tetor të vitit 2021, është realizuar plani i punës.



Organizimi i takime dhe punëtorive për ndarje të përvojave e praktikave të mira në zbatimin e kurrikulave me përfshirje relevante të shkollave (pilot) dhe palëve të interesit;

- Pjesëmarrja në trajnimin për ekipin vlerësues, si dhe trjanimi për zhvillimin e data-bazës në nivel komunal për grupet e marginalizuara;
- Takimet të rregullta individuale me prindër;
- Takime të rregullta me komunitetin dhe organet e sigurisë;

- Takime me policinë në komunitet, me stacionin “Qendra” dhe “Jugu” për të bërë planin për fillimin e vitit të ri shkollor 2021/2022 dhe për të planifikuar aktivitete të përbashkëta për të siguruar siguri dhe vetëdijesim për nxënësit.

Takim me Policinë e Kosovës për t’u dakorduar për aktivitetet e përbashkëta, të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e situatës së sigurisë dhe edukimit në shkolla.

DKA realizoi një takim të përbashkët me përfaqësues të Policisë së Kosovës, të cilët edhe për këtë vit shkollor në bashkëpunim me psikologët e shkollave, me qëllim të parandalimit të dukurive negative, do të implementojnë projektin për parandalim të dukurisë aktuale dhe mjaft shqetësuese, atë të bullizmit.



I ngarkuari me punë, Z. OGASAWARA Mitsunori mori pjesë në ceremoninë e inaugurimit të "Projektit për renovimin e aneksit të SHFMU "Meto Bajraktari" në Prishtinë, njëri ndër projektet e GGP për vitin fiskal 2020.

Z. OGASAWARA tha se Japonia i ka dhënë rëndësi sektorit arsimor përgjatë viteve të mbështetjes së Kosovës. Në fakt, pothuajse çdo vit kemi projekte për të ringjallur objektet e shkollave dhe kopshteve në Prishtinë. Ai përsëriti se, nën "Iniciativën e Bashkëpunimit për Ballkanin Perëndimor", Japonia ka qenë pranë Kosovës dhe do të vazhdojë të mbështesë përmirësimin e jetës së njerëzve në Kosovë.



Qëllimi i projektit ishte siguria dhe përmirësimi i mjedisit mësimor për nxënësit, duke rinovuar aneksin e shkollës. Përmes këtij projekti u riparuan 49 dritare, 28 dyer, 1170 metra katrorë tavane, 1850 metra katrorë mure të brendshme, 3 tualete, kanalizime, 17 njësi ngrohëse dhe 60 metra çati. Pritet që 1,500 studentë dhe 91 mësues të përfitojnë drejtpërdrejtë nga projekti me një mjedis të sigurt arsimor në objektet e renovuara.



Gjatë periudhës si ushtruese e detyrës së drejtorit në SHMM "Dr. Ali Sokoli", në bashkëpunim me DKA të Prishtinës, u realizua projekti "Barnatorja e improvizuar" në laboratorin për profilin teknik të farmacisë. Në këtë laborator po ashtu edhe profili i infermierisë së përgjithshme do të ketë mundësi t'i realizojë disa module dhe të punojë me medikamente të ndryshme.

Sot nxënësit patën mundësinë që praktikën profesionale, si pjesë përbërëse të planit dhe programit shkollor, ta realizojnë edhe brenda shkollës.



Sektori i Teknologjisë informative në Kosovë është mundësi zhvillimi për vendin, prandaj si Komunë po krijojmë të gjitha mundësitë që të rinjtë tanë të cilët janë të orientuar nga ky sektor, t'i kenë të gjitha kushtet për zhvillim profesional.

Drejtoresha e Arsimit, znj. Shpresa Shala, ka inspektuar në terren punimet në renovimin e Qendrës së Kompetencës “Gjin Gazulli”, apo ish-objektin e Shkollës Ekonomike dhe Fakultetit të Bujqësisë.

Përmes mbështetjes së Qeverisë së Luksemburgut, kjo shkollë do të jetë ndër më të avancuarat dhe profesionale në sektorin e TIK.

Ne synojmë që mësimi në këtë shkollë të fillojë në shtatorin e vitit 2022, me një infrastrukturë tepër të avancuar, me rreth 5100 metra katrorë.






DKA gjithmonë ka qenë përkrahëse e fuqishme në bashkëpunimet me shkollat nga Evropa.

Znj. Shpresa Shala, drejtoreshë e DKA –së, mori falënderime për pritjen dhe mbështetjen që bëri për delegacionin dhe mësuesin Kemajl Çallaku, përfaqësues i shkollës "Ana Frank " nga Dortmundi i Gjermanisë.

Drejtoresha Shala u njoftua për bashkëpunimin e radhës mes dy shkollave partnere.



- ***Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;***
- Ekipi vlerësues për nxënës me nevoja të veçanta i Komunës së Prishtinës, gjatë muajit tetor ka realizuar gjashtë vlerësime pedagogjike të fëmijëve me nevoja të veçanta.



Gjatë muajit tetor është realizuar një takim në mes Ekipit vlerësues të Komunës së Prishtinës dhe drejtorit rajonal të Save the Children për rajonin e Lindjes së Mesme dhe Evropës Lindore, z. Jeremy Stoner.

Takimi u mbajt në dhomën miqësore në objektin e ri të Komunës, ku janë shpalosur të arriturat dhe sukseset e ekipit vlerësues, si dhe sukseset e bashkëpunimit të DKA-së me organizatën “Save the Children”.


Janë duke u bërë përgatitjet për organizimin e trajnimit për mësues të lëndës edukatë qytetare dhe mësues klasor me temën “Të drejtat e fëmijëve” në bashkëpunim me IPEDU-në.

- *Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;*

Buxheti i shpenzuar dhe Alokuar, tetori 2021				
Kategoria Eko.	Alokim	Shpenzim	Zotim - Obligim	Mbetje -S=
Paga	1,493,402.99	1,493,402.99	-	-
Komunali	243,951.83	192,882.50	-	51,069.33
10-M.SH	1,293,912.54	284,385.76	98,652.00	910,874.78
21-M.SH	672,930.24	-	23,484.95	649,445.29
Subvencione	51,310.00	19,650.00	-	31,660.00
Donacione	76,256.62	75,756.62	-	500.00
FB-21-Kapitale	4,000,000.00	600,564.71	433,110.50	2,966,324.79

FB-22- Kapitale	3,356,542.30	807,093.80	87,089.00	2,462,359.50
FB - 04 M.SH	30,379.00	22,890.30	5,625.65	1,863.05
FB - 04 KAPITALE	28,146.00	22,738.50	5,407.50	-
Gjithsej:	11,246,831.52	3,519,365.18	653,369.60	7,074,096.74

- **AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA** - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.



- Rregullimi i oborrit ne SHFMU “Faik Konica”



- *Dinamika e punëve të realizuara gjatë muajit tetor*



Takim i përfaqësuesve të SHFMU "Nëna Terezë" dhe DKA-së me rastin e fillimit të punimeve në shkollë.

Shkolla është mirënjohëse për të gjithë që morën parasysh kërkesën për ndërtimin e objektit të ri shkollor.



Takimi zyrtarëve të arsimit të DKA-së me **OJQ "Norma"**

- Qëllimi kryesor i **OJQ-së "Norma"** është që përmes diskutimeve mbi barazinë gjinore, parandalimin e dhunës me baza gjinore dhe diskriminimin me qëllim të përmirësimit të sjelljes midis bashkëmoshatarëve, përmirësimit të marrëdhënies mësimdhënës-nxënës.

- Aktiviteti do të realizohet me mbajtjen e 18 takimeve me institucione të ndryshme, si: Ministria e Arsimit, Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, drejtorët e shkollave të mesme të larta të Komunës së Prishtinës dhe psikologët e shkollave të mesme të larta.



[Kosovar Center for Security Studies - KCSS](#)

Në kuadër të projektit "Të rinjtë për të rinjtë - rritja e qëndrueshmërisë për grupet e marginalizuara" e përkrahur nga [U.S. Embassy Pristina, Kosovo](#), Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), së bashku me Qendrën për Arsim të Kosovës (KEC), ka organizuar

konferencën me aktorët relevantë, me temën "Të arriturat dhe sfidat në edukimin e nxënësve të kthyer nga zonat e konfliktit".



Fokusi i diskutimit ishte në sfidat dhe nevojat e fëmijëve të kthyer në raport me procesin arsimor dhe rolin e institucioneve të arsimit dhe institucioneve tjera relevante në fasilitimin e mëtutjeshëm të këtij procesi.



- ***AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtorja juaj për muajin raportues.***
 - Kontraktimi i një kompanie nga Komuna për rregullimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të TIK-ut në shkolla;
 - Përmirësimi i planifikimit buxhetor (me të gjitha palët e interesit);
 - Përkrahja e shkollave për përmirësimin e performancës në bazë të rezultateve të vlerësimit të jashtëm;
 - Kontraktimi i operatorit ekonomik për organizimin e transportit të nxënësve.

- ***Takimet me palë***

Drejtorja e Arsimit, gjatë muajit tetor të vitit **2021**, ka realizuar mbi **81** takime me palë; Takimet me palë në Drejtorinë e Arsimit janë të planifikuara katër ditë në javë.

- ***Takimet me institucione të tjera***
 - Progresi i realizimit të planit të prokurimit;

- Takim me anëtarët e KEPTSH-së;
- Takimi i KSHLM-së;
- Asociacioni i Komunave të Kosovës – MASHT.

- ***Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare***

Gjatë muajit tetor të vitit 2021, në Drejtorinë e Arsimit nuk është adresuar asnjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare.

- ***Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër***

Gjatë muajit tetor të vitit **2021**, janë pranuar gjithsej **70** lëndë, prej tyre të miratuara janë **15**, të refuzuara **7** lëndë, të pezulluara 32, të anuluar **0** dhe në proces janë edhe **16**.

- ***Takime të tjera***

- Takime me drejtues të institucioneve edukativo-arsimore;
- Takim me drejtueset e IP-ve;
- Takim me përfaqësueset e edukatoreve në institucionet parashkollore;
- Takime me mësimdhënës.
- Vizita speciale në shkolla fillore të mesme të ulëta dhe shkolla të mesme të larta.

- ***SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutem shpjegoni në këtë hapësirë.***

- Riorganizimi dhe përcaktimi i përgjegjësive, punëve dhe detyrave në Drejtorinë e Arsimit;
- Mungesa e një stafit profesional e mbikëqyrës të veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Mungesa e një mekanizmi për vlerësimin e performancës të stafit edukativo-arsimor;
- Mungesa e zyrtarëve ligjorë në Drejtorinë e Arsimit;
- Numri i vogël i nxënësve në disa shkolla të viseve rurale;
- Kompetenca të përziera dhe jo të qarta;
- Implementimi i Kurrikulës së re;
- Infektimi i mësimdhënësve me virusin COVID-19, dhe zëvendësimi i tyre.

- **REKOMANDIME** - *Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë etj.*
 - Riorganizimi i menjëhershëm i Drejtorisë komunale të Arsimit, në bazë të përgjegjësiave, punëve dhe detyrave që ka kjo drejtori;
 - Plotësimi i stafit profesional sipas kërkesave dhe nevojave të Drejtorisë së Arsimit.

- **AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES** -*Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues*
 - Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor;
 - Vizita sistematike në institucionet edukativo-arsimore;
 - Vizita speciale IEAA;
 - Përkrahja e shkollave për përmirësimin e performancës në bazë të rezultateve të vlerësimit të jashtëm;
 - Mbikëqyrja, mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
 - Fuqizimi i aktiveve profesionale;
 - Përmirësimi i planifikimit buxhetor (me të gjitha palët e interesit);
 - Sigurimi i buxhetit adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;
 - Stimulimi i menaxhmentit të (DKA-së shkollë), dhe mësimdhënësve të dalluar sipas performancës;
 - Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
 - Hartimi dhe zbatimi i planit për konsolidimin e shkollave;
 - Hartohen politika dhe rregullore për zhvillimin profesional të mësimdhënësve;
 - Krijimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave për ZHPM;
 - Organizohen punëtori të përbashkëta mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re;
 - Zbatimi i planit për tejkalimin e masave, sfidave, vështirësive, pengesave;
 - Monitorimi i zbatimit të kurrikulës;
 - Organizimi i takimeve dhe punëtorive për ndarje të përvojave dhe praktikave të mira në zbatimin e kurrikulave me përfshirje relevante të shkollave (pilot) dhe palëve të interesit;
 - Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
 - Vlerësimi i gjendjes së përgjithshme të infrastrukturës;
 - Sigurimi dhe menaxhimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës, në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re.

- Kryesisht sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Identifikohen nevojat e shkollës për mjete të TIK-ut;
- Tenderimi i kompanisë për furnizim;
- Identifikimi i nevojave të shkollave për punëtori, laboratorë, kabinete dhe materiale shpenzuese në vit;
- Hartimi i listave për nevojat e secilës shkollë për punëtori, kabinete, laboratorë dhe materiale shpenzuese;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi që janë të interesuar të kontribuojnë në shkolla;
- Krijimi i mekanizmave monitorues për përdorimin e kabineteve;
- Hartimi i rregullores që organizon (mbledhjen) ngritjen e kontributeve dhe donacioneve nga prindërit dhe komuniteti;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Zbatimi i programeve të trajnimit për edukim parashkollor;
- Aftësimi i personelit për përdorimin e metodologjive pedagogjike në zbatim të KKK-së dhe KB-së në edukimin parashkollor (Montessori, Reggio Emilia, Hap pas Hapi, Majeutika);
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatrit, nutricionisti e të tjerë në IP, me orar të organizuar sipas UA për numër të fëmijëve në IP;
- Krijimi i një ekipi komunal (zyrtarë të arsimit, zyrtarë të inspeksionit sanitarë, infrastrukturë, profesionistë të fushës etj.) për organizimin e monitorimit, mbikëqyrjes, kontrollit të zbatimit të standardeve të EPSH-së (këshillohet që ky ekip të mos merret vetëm si inspektim, por edhe si këshillues e përkrahës – në të përfshihen edhe profesionistë – ekspertë);
- Përkrahja për përmirësimin e zbatimit të standardeve të EPSH;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativoarsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i mësimi joformal në tri nivelet e arsimit (në bashkëpunim me MASHT-in dhe Qendrën Rajonale të Aftësimi Profesional);
- Analiza e gjendjes dhe nevojave në arsimin e mesëm;
- Organizimi i diskutimeve publike rreth regjistrimit në vitin shkollor 2020/2021, dhe konsultime me MASHT;
- Në nivel komunal dhe institucional, organizohen takime informative dhe konsultative me prindër dhe me komunitetin me orar dhe agjendë të caktuara saktë;
- Takimet të rregullta individuale me prindër;
- Takime të rregullta me komunitetin;
- Angazhimi aktiv i prindërve në realizimin e kurrikulave;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtë kurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- DKA-ja përkrahë NNV dhe nxënësit me talente;

- Përkrahja e punës së Ekipit komunal për vlerësim;
 - Infrastrukturë afirmative për të nxënë efektiv;
 - Identifikimi i dhunës përmes pyetësorëve anonim;
 - Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
 - DKA-ja harton Rregulloren për mjedis miqësor për të nxënë efektiv;
 - Organizohen ngjarje për vetëdijesimin e punëtorëve arsimorë për nevojën e krijimit të kushteve optimale të punës e mësimin nëpër shkolla;
 - Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;
 - Evidentimi i të hyrave vetanake;
 - Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
 - Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
 - Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
 - Pranimit i lëndëve për aprovim;
 - Zotimi i lëndëve.
-
- ***TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.***